



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L- 40, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kreqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.4.2026, merr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONET E AKSIONARËVE TË
NDËRMARRJEVE PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

CAKTOHEN anëtarët e komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës: Ngrohtorja e qytetit “Termokos”, SHA; Ndërmarrja publike “Trafiku urban”, SHA; Ndërmarrja publike “Sport - Marketing”, SHA; Stacioni i Autobusëve në Prishtinë, SHA; Ndërmarrja publike “Kuzhina qendrore”, SHA, dhe Ndërmarrja publike “Pallati i Rinisë”, SHA.

I.

Anëtarë të komisioneve të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Ngrohtorja e qytetit “Termokos”, SHA:

- 1. Egzon Pacolli;**
- 2. Bekim Gashi.**

2. Ndërmarrja publike “Trafiku urban”, SHA:

- 1. Rifadije Sopi;**
- 2. Lindita Rexhepi,**

3. Ndërmarrja publike “Sport – Marketing”, SHA:

- 1. Pëllumb Bajçinovci;**
- 2. Driton Rukiqi.**

4. Ndërmarrja publike “Stacioni i autobusëve”, SHA:

- 1. Kreshnik Smajlaj;**
- 2. Shkëlqim Osmanaj.**

5. Ndërrmarrja publike “Kuzhina qendrore”, SHA:

- 1. Dasmor Durmishi;**
- 2. Donjeta Dragusha.**

6. Ndërrmarrja publike “ Pallati i Rinisë”, SHA:

- 1. Arian Shabanaj;**
- 2. Sabri Dragusha.**

II.

Komisionet komunale të aksionarëve kanë të drejtë të veprojnë në emër të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërrmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

III.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen pjesët e Vendimit nr. 01-020/04-62668/22, i dt. 21.3.2022 lidhur me këto NPL, Vendimi nr. 01-020/04-122005/24, i dt. 16.9.2024 dhe Vendimi me nr. 01-020/04-121999/24, i dt. 16.9.2024 lidhur me emërimin e anëtarëve në komisionet komunale të aksionarëve.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-62823/26, më 29.4.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

